**VENDIM**
**Nr. 705, datë 21.8.2013**

**PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e vitit 2013, t’i shtohet fondi prej 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh, për objektin “Rikonstruksioni i Komandës së Gardës së Republikës”.
2. Fondi, prej 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**